

1406 03.04.24

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1397 të datës 03.04.2024, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më date 04.04.2024 shpall:

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita e punës: Kontrollor i komunikacionit

Numri i pozitave: 1

Niveli i pagës: XV

Kohëzgjatja e kontratës: Ne afat të pacaktuar

Kualifikimet: Shkollim i Mesëm

Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune

Periudha provuese: 3 muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontrollon sipas vlerësimit apo orarit nga Shefi i Kontrollës në autobusët e ndërmarrjes në çdo kohë dhe në çdo vend sipas dispozitave ligjore (aty ku nuk pengohet trafiku);
- Kontrollon udhëtarët, stafin e autobusëve (shoferët dhe kondukterët) e ndërmarrjes në çdo kohë dhe në çdo vend duke respektuar dispozitat ligjore në komunikacion, aty ku nuk e pengon trafikun;
- Sipas udhëzimeve të Përgjegjësit të Kontrollës, kontrollon orarin e punës së dispeçerëve të linjave si dhe orarin e qarkullimit të autobusëve;
- Kontrollon qëndrimin, përgatitjen dhe dukjen për punë të dispeçerëve dhe stafit të autobusit (shoferëve dhe kondukterëve) si dhe pastërtinë brenda dhe jashtë autobusëve;
- Kryen regjistrime të rregullta dhe të jashtëzakonshme për të gjithë llogaridhënësit (shoferëve, fletë-udhëtimet e autobusëve, kondukterëve);
- Kryen kontrollin gjatë punës së rregullt të kondukterëve dhe verifikon pajisjen e udhëtarëve me kuponë fiskal dhe bileta të tjera të lëshuara nga persona të autorizuar të ndërmarrjes, verifikon origjinalitetin e kuponëve fiskal-biletave, fletë-urdhëresave të udhëtimit, fletë-udhëtimet tek relacionet e kontraktuara dhe në rast parregullsie ndërmerr masa të nevojshme për iniciimin e procedurave duke shkruar fletëparaqitje;
- Verifikon nëse kondukterët posedojnë të hollat e paguara nga udhëtarët në emër të kuponëve fiskal të shitur;
- Vërteton se shoferët dhe kondukterët janë duke qarkulluar në relacionin e caktuar dhe në kohë sipas orarit të lëshuar nga personat e autorizuar të ndërmarrjes;
- Vërteton nëse shoferi i autobusit posedon patentë shoferin, urdhëresën e rrugës së nënshkruar nga kontrollori teknik i ndërmarrjes, si dëshmi e gatishmërisë së autobusëve për qarkullim në trafik;

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 (0) 45 10 11 23

- Është i obliguar të ndal autobusin me shenjën “STOP” në vendin ku nuk pengon qarkullimin në trafik;
- Kontrollori shqipton gjopa për qytetarët të cilët gjenden në autobus dhe kanë humbur apo nuk kanë paguar biletën e autobusit;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përkrahimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga mbikëqyrësi;
- Për punën e tij i përgjigjet Përgjegjësit të Njesisë së Kontrollës së Brendshme Inspektuese.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollim i Mesëm;
- Të ketë njohuri të mira për çështjet teknike të autobusit.
- Përvoja e punës në pozitën e Kontrollorit të komunikacionit është përparësi.
- Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në grup nën presion;

Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;>
- CV
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm

Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë punëtorët e rregullt të NPK “Trafiku Urban” SHA.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

NPK “ Trafiku Urban” SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 (0) 45 10 11 23

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com

Konkursi është i hapur nga data **04.04.2024** dhe përfundon më datë **18.04.2024** në ora **24:00**.

Kalendari i përafët i zhvillimit të proceduarve: Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **13.05.2024**.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:
03.04.2024

Kryeshef Ekzekutiv
Burim Maraj
N.P.K.

"TRAFIKU URBAN"
S.H.A.
PRISHTINË
MUNICIPALITY PUBLIC ENTERPRISE